

Procesverbal

Nga

FAZA E DYTË e diskutimeve publike për Projekt-Kushtetutën e Kosovës

Koha dhe vendi: 22 shkurt, Viti

Panelistët: Fatmir Fehmiu, Kadri Kryeziu, Lirie Osmani – anëtarë të Komisionit Kushtetues

Fjala hyrëse e panelistëve:

Fatmir Fehmiu

Projekt-kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila gjendet para jush në diskutim është karakteristike dhe e veçantë si për nga koha e rrethanat ashtu edhe për nga metodologjia e punës e cila po zgjat më shumë se një vit. Andaj ajo nuk dallon nga kushtetutat e vendeve demokratike të botës përfshirë edhe ato vende që tashmë janë në tranzicion. Kushtetuta e Republikës së Kosovës cilësohet nga specifikat e veta të determinuar nga proceset e zhvilluara shoqëroro-politike të brendshme dhe ndërkombëtare.

Projektkushtetuta e Republikës së Kosovës artikulon vullnetin e popullit, të shtetasve të shtetit sovran dhe të pavarur. Projekt-kushtetuta e Republikës së Kosovës aspiron madje edhe krijon bazë të mirë për të lëvizur vlerat kushtetuese përkatësisht të së drejtës kushtetuese në Kosovë që janë të pandara nga realiteti jetësor madje edhe nga kushtet objektive dhe subjektive të këtij realiteti.

E drejta kushtetues e Kosovës nuk është vetëm ajo që shkruhet në kushtetutë por edhe ajo që ndejnë njerëzit dhe shtetasit për pozitën e vet do të thotë të drejtat, liritë dhe detyrat e tyre për realizimin e tyre. Antropologjia bashkëkohore vërteton mendimet shkencore se njerëzit dhe shtetasit nuk janë ajo që flasin dhe mendojnë për vete por ajo që bëje dhe veprojnë për të mirën e vet dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Komisioni kushtetues do të konsiderojë se ka kryer misionin human e fisnik. Ka përmbushur detyrat e veta profesionale kushtetuese e juridike të cilat ia ka parashtruar vetes gjatë hartimit të këtij akti themelor. Këtë e provojnë përmbajtja e integrale e tekstit të Projektit të Kushtetutës, preambula dhe pjesa normative të cilat i përmbajnë 14 kaptinat e saj.

Duhet nënvizuar se projektkushtetuta e Republikës së Kosovës shpreh materializimin e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës e cila është artikulluar në tërë tekstin integral të saj e që përkrahet nga mbarë opinioni ndërkombëtar. Ju lutem që vërejtjet tuaja lidhur me nenet e veçanta t'i parashtroni këtu por edhe me shkrim drejtuar Komisionit Kushtetues apo në uebsajtin e internetit.

Më lejoni t'ju lus të prezantoni mendimet e juaja qoftë në aspektin parimor, qoftë konkret dhe ato t'i sistemoni e t'i dërgoni në adresën e Komisionit kushtetues. Komisioni kushtetues t'i shfrytëzojë në favor të asaj që quhet perfeksionim i tekstit që edhe ju të jeni koautor të hartimit të kësaj kushtetute ashtu që perfeksionimi i aktit të cilin e kemi në diskutim do ta zgjedhë atë që quhet e mundshme e përkryer për momentin.

Kadri Kryeziu

Përhëndetje për qytetarët Vitisë. Unë kam qenë edhe herën tjetër kur kemi pasur debatin për informacionin për Projektkushtetutën. Ju tash e keni draftin në duar, me siguri që e keni shpalosur. Jam i bindur se gjithë atë që kemi thënë më herët e keni në Projektkushtetutë. Kjo është një projektkushtetutë e së mundshmes për momentin në Kosovë. Tash do të jemi më të relaksuar.

Kushtetuta e Kosovës është një kushtetutë praktike, funksionale, fleksibile, kushtetutë e cila, jemi munduar t'i plotësojë nevojat e gjithë qytetarëve të Kosovës respektivisht shumicës së popullatës. Në të kemi punuar, njerëz të politikës, njerëz të shoqërisë civile, ekspertë vendorë, ekspertë ndërkombëtarë të të gjitha fushave. Shpresoj se kjo kushtetutë do t'i plotësojë nevojat e qytetarëve të Kosovës në të gjitha fushat sociale, politike, ekonomike e kështu me radhë. Kësaj radhe do të jemi më shumë dëgjues dhe sugjerojmë që të bëni pyetje dhe ndonjë rekomandim. Ne do të përpiqemi të përgjigjemi ose t'i përcjellim në adresë të Komisionit kushtetues shtetëror për hartimin e Projektkushtetutës.

Lirie Osmani

Kosova u bë shtet i pavarur dhe sovran, u pranua ndërkombëtarisht dhe Kosova prej tani është faktor ndërkombëtar. Prandaj Kosovës i duhet tani kushtetuta, akti më i lartë juridik. Sikurse thanë edhe parafolësit, është marrë për bazë vullneti i popullit për shtet sovran dhe të pavarur si dhe parimet themelore të Pakos së ish presidentit Ahtisari. Gjatë punës në kushtetutë kemi pasur para vetes shumë kushtetuta të shteteve dhe të vendeve demokratike të cilat i kemi konsultuar dhe jemi munduar që kushtetuta t'i përmbajë të gjitha normat të cilat e obligojnë shtetin për të qeverisë në mënyrë demokratike, për të respektuar të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe për të zhvilluar një ekonomi e cila do përparuar vendin. Desha vetëm të theksoj se në Komision kanë qenë profesorë të njohur të të drejtës kushtetuese. Kam fatin që jam këtu me dy profesorë shumë të njohur që kanë një përvojë shumë të gjatë sa i përket përpilimit të një kushtetute që është pretenduar të jetë sa më complete, sa më e kuptueshme edhe për qytetarin më të thjeshtë dhe çështjet që nuk janë paraparë me kushtetutë është paraparë të rregullohen me ligje. Prandaj sot jemi këtu që t'i dëgjojmë propozimet tuaja.. Sepse ne nuk pretendojmë që kjo kushtetutë është e përkryer prandaj mendojmë se ndoshta duhet të bëhen disa përmirësime.

Pyetjet / Komentet e Pjesëmarrësve:

Kapitujt e Kushtetutës

Preambula

Pyetje

A mund të ketë përparësi ndaj kësaj kushtetute Pakoja e Ahtisarit?

Fatmir Fehmiu

Preambula si pjesë e kushtetutës mund të jetë por mund edhe mos të jetë. Në shumë kushtetuta të botës nuk ka preambulë por në disa kushtetuta të shteteve të botës ka preambulë varësisht prej konceptit dhe asaj që quhet mënyrë e shtjellimit të një akti siç është kushtetuta. Në këtë preambulë është përfshirë si e quajmë ne juristët *delege ferenta* siç duket, sepse kur thuhet: Ne Populli i Kosovës të vendosur për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës... dhe vazhdon me këto pikët tjera të cilat janë materializim i Deklaratës për Pavarësinë. Deklarata për Pavarësi nëse jeni duke përcjellur me vëmendje stacione të ndryshme informative të shteteve të cilat e kanë pranuar dhe po e pranojnë Kosovën, e kanë vlerësuar si deklaratë me përmbajtje shumë progresive për shumë arsye. Arsyeja e parë është ajo që ka qenë gjithmonë karakteristikë e popullit tonë: falja, pajtimi progresi, dhe të gjitha ato që përcjellin. Prandaj vet fakti që këto i keni në mënyrë precize të prezantuara të shkruara, tregojnë çfarë synimi ka populli shqiptar. Sikurse kemi parë Pakoja e Ahtisarit nuk përmban asgjë tjetër përveç dokumenteve ndërkombëtare të cilat i kemi radhitë edhe

ne në pjesën që quhet Parimet e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Aty qëndron edhe si bëhet ratifikimi i konventave.

Dispozitat themelore

Qytetari

Si është vendosur për simbolet?

Fatmir Fehmiu

Për simbole ka qenë një konkurs. Në këtë konkurs me disa kritere, kanë konkurruar 1900 vetë. Prej tyre është bërë klasifikimi i ekspertëve të fushave të kësaj lëmie. Një procedurë demokratike ka ndodhë edhe me flamurin pse është ky flamur dhe ato tashmë janë shpjeguar.

Qytetari

Si qëndron çështja e zgjedhjes me referendum?

Fatmir Fehmiu

Ju e dini se Kuvendi është organi më i lartë i pushtetit, i përbërë nga deputetët. Kemi dy forma të demokracisë, të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Kuvendi përfaqëson sovranitetin e popullit. Referendumi është poashtu një institut dhe për këtë ekzistojnë ligje për mënyrën. Sovraniteti i Republikës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet në pajtim me këtë kushtetutë përmes përfaqësuesit të zgjedhur me referendum. Në rrethanat në të cilat gjendemi për tu përgatitur një referendum duhen së paku 6 muaj. Deklarata e pavarësisë duhet sa më parë të artikulohet, e artikulimi bëhet me kushtetutë. Kur e kemi hartuar Kushtetutën e Kaçanikut pas pesë vjetësh kemi parë se çka duhet me ndryshuar e lëre më tash pas 18 vjetësh. Kushtetuta nuk është ikonë imagjinare, nuk është pikturë e imagjinuar, por pasqyrë e një situatë konkrete të rrethanave konkrete me faktorin subjektiv. Edhe në hartimin e kësaj projektkushtetute kanë marrë pjesë ekspertë të njohur ndërkombëtarë për materializimin e të gjitha dokumenteve të Kombeve të Bashkuara. Jemi këtu për të marrë mendime të shqyrtojmë solucionet dhe të shqyrtohet çka duhet nesër dhe çka pasnesër.

Të drejtat dhe liritë themelore

Qytetar

A janë të materializuara të drejtat e njeriut në këtë Projekt-kushtetutë apo është fjala për manipulim sepse në një mënyrë është pamundësuar e drejta e vetëvendosjes?

Fatmir Fehmiu

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile e Politike me protokollet e saj përmban këtë që thatë ju. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e Pakicave kombëtare, këto janë në nenin 22. Të gjitha këto akte janë të numëruara edhe në këtë dokumentin që ne e quajmë bazament për artikulum në rrethana dhe situatë të veçantë. Prandaj nuk qëndron ajo që nuk janë të materializuara. Përkundrazi sepse unë që 44 vjet merrem me këtë problematikë, kam qenë edhe një prej hartuesve të Kushtetutës së Kaçanikut. Nuk ka nevojë të përdoret fjala manipulim. Kur e kam bindë veten në zgjedhjen e këtij profesioni atëherë kam të drejtë ta bind edhe kolegun tim, kolegen time dhe njeriun me të cilin bëj dialog. Është një aforizëm i vjetër. Dialogu është nëna e dijes mohimi i dialogut është perandoresha e marrinave. Mos u frikësoni në atë aspekt. E drejta e vetëvendosjes, nëse është neni 1 pika 1 e Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave Civile e Politike, pika 2 është sovraniteti ekonomik, pika tre është ato shtete që kanë nën kujdestari ndihmohen për pavarësi. Të njëjtën gjë e keni në Konventën për të

drejtat sociale, ekonomike e kulturore me të njëjtin mbarështim.

Qytetari

Sa i plotëson kjo Projekt kushtetutë kushtet për të integritet territorial?

Kadri Kryeziu

Sa i përket Trupave Mbrojtëse të Kosovës do të transformohen me dinjitet. Ushtria e Kosovës do të jetë profesionale. Në të ardhmen e afërt do të kemi edhe Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Mbrojtjes. Ushtria e Kosovës do të ketë 1.200 ushtarë të rregullt, kurse 800 do të jenë rezervë me një emër do të jenë civilë por të inkuadruar në paktin NATO. Jo vetëm si ushtri por edhe si shtet Kosova do të inkuadrohet në Paktin NATO dhe ushtria e Kosovës do të jetë profesionale. Në momentet e njohjes nga shtetet vendimmarrëse siç është Amerika etj. përveçse krijohen raporte diplomatike politike, shtetet kanë për obligim edhe mbrojtjen e integritetit territorial. Kështu që ne mendojmë se kjo projekt-kushtetutë i plotëson edhe kushtet në të gjitha sferat në drejtim të integritetit territorial të Kosovës. Kosova është shtet unik, sovran dhe demokratik.

Fatmir Fehmiu

Ju lutem që këtë pyetje ta mbarshtroni në letër dhe t ia dërgoni Komisionit Kushtetues.

Lirie Osmani

Kushtetuta e Kosovës është akti më i lartë juridik. Në draftin e kushtetutës së Kosovës është paraparë edhe gjykata kushtetuese e cila është e autorizuar për të interpretuar kushtetutën. Sa i përket pakos së Ahtisarit, profesori e shpjegoi mirë se krejt dokumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, të drejtat e komuniteteve dhe organizimin territorial janë të përfshira në këtë pjesë. Pakoja nuk është marrëveshje me të cilën është manipuluar populli por është një marrëveshje e cila është miratuar nga Kuvendi për arsyet ne të cilën sot gjendemi - të jemi shtet i pavarur dhe sovran.

Qytetari

A i keni veshur palltot e UNMIK-ut kur keni ardhur këtu të flisni për një dokument të imponuar, sepse Pakoja e Ahtisarit cenon pronat e banorëve të Debëllidës që kanë mbetur matanë kufirit me Maqedoninë. A mendoni se me këtë cenohet e drejta territoriale e Kosovës?

Kadri Kryeziu

Ne kemi ardhur ta sqarojmë Projektkushtetutën e Kosovës e cila i paraprin aktit më të lartë për pavarësi të Kosovës. Sa i përket problemit të Debëllidës kjo është e paraparë edhe me Pakon e Ahtisarit që të zgjidhet me Marrëveshje në të ardhmen. Të dy qeveritë, ajo e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Maqedonisë do të merren vesh për problemet e kufirit të Debëllidës.